

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

- Rolin dhe punën e bërë nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), si institucion i pavarur, në përputhje me atributet që i njeh ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

- Angazhimin e Zyrës së Komisionerit për të garantuar të drejtën e informimit dhe transparencën e autoriteteve publike, rolin aktiv dhe korrekt të tij, në lidhje me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatimin të ligjit për të drejtën e informimit, rolin sensibilizues të Komisionerit, në funksion të zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit.

- Rolin aktiv të Zyrës së Komisionerit në shqyrtimin e ankesave, zgjidhjen me ndërmjetësim, kryerjen e inspektimeve dhe hetimeve admini-strative në të dyja fushat, në të cilat ushtron veprimtarinë institucionale.

- Ofrimin e ekspertizës ligjore, me qëllim përshtatjen e standardeve të mbrojtjes së të dhënave personale me zhvillimet e reja teknologjike.

- Procesin në rritje të numrit të njoftimeve dhe regjistrimeve nga kontrolluesit.

- Anëtarësimin në grupin e punës së artikullit 29 të direktivës 95/46 /CE.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2015:

- Zyra e Komisionerit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankesash në të dyja fushat që mbulon, të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- Ka rritur ndjeshëm numrin e inspektimeve në të drejtën për informim, në krahasim me vitin e mëparshëm.

- Ka zhvilluar monitorimin dhe mbikëqyrjen e përpunimit të të dhënave personale, nëpërmjet trajtimit të më shumë ankesave dhe rritjes së numrit të hetimeve administrative në kontrollues publik dhe privat, kryesisht në sektorë të mëdhenj.

- Ka vijuar zbatimin e ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, duke monitoruar periodikisht programet e transparencës për auto-ritetet publike.

- Ka përforcuar kapacitetet institucionale përmes trajnimeve, duke ofruar trajnime për titullarët dhe koordinatorët e pushtetit vendor, por edhe për shoqërinë në tërësi.

- Është bërë pjesë e strategjisë antikorrupsion dhe reformës në administratën publike me indikatorë konkretë.

- Ka rritur numrin e vendimarrjeve dhe rekomandimeve, duke dhënë dhe rekomandime unifikuese në sektorë të veçantë.

- Gjatë vitit 2015, KDIMDP-ja ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi ndër-institucionale me ILDKPKI-në, QKR-në, QKL-në, në zbatim dhe të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të Progresraportit të BE-së për vitin 2015.

- Ka punuar për forcimin e marrëdhënieve me median dhe publikun, duke nënshkruar marrë-veshje bashkëpunimi me AMA-n.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2016, kërkon nga Zyra e Komisionerit:

- Rritjen e numrit të inspektimeve, lidhur me respektimin e së drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus të veçantë inspektimet kryesisht me plan tematik.

- Thëllimin e hetimeve administrative, kryesisht në sektorë ku përpunohen të dhënat sensitive.

- Ndjekjen dhe zbatimin e programeve të transparencës, në mënyrë të veçantë zbatimin nga gjykatat dhe organet e qeverisjes vendore.

- Rritjen e masave administrative për shkeljet ligjore të konstatuara, me fokus të veçantë rastet

e refuzimit të informacionit dhe mungesës së programit të transparencës.

- Kryerjen e hetimeve administrative të thelluara, për rastet e trajtimit të ankesave abuzive, në lidhje me të drejtën e informimit.

- Kualifikimin e thelluar të kapaciteteve institucionale, nëpërmjet trajnimeve ndër-kombëtare dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

- Monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara subjekteve kontrolluese dhe përpu-nuese gjatë viteve 2015–2016.

- Organizimin e trajnimeve, kryesisht në sektorin medias, sistemin gjyqësor, organet e rendit dhe administratën publike.

- Rritjen ekspertizës dhe opinioneve ligjore për projektakte ligjore dhe nënligjore, të lidhura me respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- Angazhim në ndjekjen e procedurës për certifikimin e Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

- Hartimin dhe miratimin e strategjisë së Zyrës së Komisionerit për vitet 2017–2020.

Miraturar në datën 21.4.2016

KRYETARI
Illir Meta